



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.01.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Shqyrtimi i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 124/2015 "Për eficiencën e energjisë"" (*komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Arben Pëllumbi, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici dhe Edmond Panariti.

Mungojnë:

Florjon Mima, Lorenc Luka, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Dorina Çinari - Zëvendësministre e Energjisë dhe Infrastrukturës

Entela Cipa - Drejtore e Agjencisë për Eficencën e Energjisë

Enea Karakaci - Drejtor i Zyrës Juridike në këtë ministri

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Përshëndetje!

Meqenëse e kemi kuorumin e nevojshëm fillojmë mbledhjen!

Sot kemi parashikuar shqyrtimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 124/2015 "Për eficiencën e energjisë"". Relator i projektligjit është zoti Arben Pëllumbi. Kemi ftuar sot edhe përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës. Para se ta marrin fjalën përfaqësueses së ministrisë, ia jap fjalën relatorit.

Arben Pëllumbi - Ju falënderoj, kryetar!

Në fakt, nga shqyrtimi që i kam bërë këtij projektligji, do të dëshiroja që në fillim të dëgjonim opinionin e ministrisë pas diskutimit që kemi bërë paraprakisht bashkërisht. Pastaj do të diskutojmë edhe ne këtu dhe do të japim mendimet tona se si do të procedojmë.

Niko Peleshi – Dakord.

Fjalën e ka zëvendësministrja!

Dorina Çinari - Ju falënderoj, të gjithëve!

Në kuadër të reformës së derregullimit dhe të përpjekjeve me qëllim krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, MEI ka skanuar të gjitha licencat, autorizimet, certifikatat dhe lejet që lëshon. Në këtë kuadër është inspektuar edhe seti i lejeve dhe i licencave, që janë përcaktuar në anekset 1 dhe 2, të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar".

Në këtë kuadër u vendos që në ligjin nr. 124/2015 "Për eficiencën e energjisë"" të bëhen disa thjeshtime.

Me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencës për audituesin energjetik dhe licencës për shërbimet energjetike, të cilat janë parashikuar si licenca në ligj, por akoma nuk janë përfshirë në njërën prej kategorive dhe nënkategorive të përcaktuara në aneksin 1 të VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009. Me shfuqizimin e kësaj licence ushtrimi i veprimtarisë të auditimit të energjisë dhe shërbimet energjetike do të jenë të lira.

Ndërkohë, projektligji parashikon se veprimtaritë e auditimit të energjisë dhe shërbimet energjetike mund të kryhen vetëm nga subjektet e certifikuara për këtë qëllim.

Certifikohen për kryerjen e këtyre veprimtarive personat fizikë, të regjistruar si të tillë, që kanë aftësi teknike dhe përvojën e nevojshme për kryerjen e këtyre veprimtarive. Kjo veprimtari mund të kryhet edhe nga persona juridikë, të cilët kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e kësaj veprimtarie dhe kanë të punësuar individë të certifikuar për këtë qëllim.

Projektligji parashikon se shërbimet energjetike ofrohen nga subjekte që kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie kryerjen e kësaj veprimtarie (shërbimet energjetike dhe auditimin e energjisë).

Unë kam me vete dy ekspertë, që janë marrë me përgatitjen e projektligjit: zonjën Entela Cipa, drejtore e Agjencisë për Eficiencën e Energjisë dhe zotin Enea Karakaci, drejtor i Zyrës Juridike për të sqaruar për çështjet teknike të këtij projektligji.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Fjalën e ka relatori.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja zëvendësministre, për shpjegimet që dhatë!

Ky ndryshim në ligj vjen në formën e një projektligji të ardhur nga KM-ja në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe me Rregulloren e Kuvendit ka si qëllim derregullimin, apo thjeshtimin e procedurave për t'u pajisur me një dokument për të bërë një ekspertizë të caktuar, që në këtë rast është në fushën e eficiencës së energjisë.

Në thelb synohet thjeshtimi i procedurave. Nga një studim më i hollësishëm që i kemi bërë draftit të paraqitur edhe me ekspertët e komisionit, vëmë re se ka disa gjëra që ndoshta do të ishte mirë t'i shikonim më me korrektësi për t'i përcaktuar saktë gjatë diskutimit nën për nen, për të mos lënë hapësira për keqinterpretime apo për një menaxhim jo të saktë. Një gjë e tillë për shembull ka të bëjë me procedurën e pajisjes me certifikatë. Cili do të jetë institucioni që do të lëshojë këtë certifikatë? Do të jetë ministria, apo agjencia? Vëmë re se nuk është përcaktuar siç duhet. Unë do të propozoja që ne sot të bëjmë diskutimet përkatëse dhe kur të kalojmë në diskutimin nën për nen, të na jepet më shumë kohë për të bërë saktësimet e duhura në këtë projektligj.

Niko Peleshi – Ka pyetje?

Fjalën e ka zoti Suli dhe më pas do ta marrin fjalën zoti Beqaj dhe zoti Baraj!

Rakip Suli – Për të qenë pak më të qartë, meqenëse thatë se ka thjeshtim të procedurave, desha të di se çfarë procedurash janë thjeshtuar me ndryshimin e këtij ligji që ju po sillni sot?

Nga informacionet që kam dhe nga sa mbaj mend, para 5-6 muajsh është diskutuar për heqjen e disa barrierave, s'e mbaj mend mirë se sa kanë qenë 18 apo 19 licenca.

Konkretisht, çfarë procedurash ishin në ligj dhe çfarë procedurash heq ky projektligj?

E dyta, duke lexuar relacionin, flitet për licencimin e ushtrimit të veprimtarisë së auditimit të energjisë. Këta auditues që do të licencohen, do të jenë privatë? Çfarë kriteresh do të plotësojnë këta auditues nesër për një objekt të caktuar? Besoj se ky është koncepti i nisjes së këtij projektligji dhe, kur flasim për eficiencë të energjisë elektrike, shembullin e parë do ta japin vetë objektet shtetërore, sepse ne flasim për një investim për kursimin e energjisë elektrike dhe a po e japim ne të parët këtë shembull? A po implementohet kjo në objektet e institucioneve shtetërore? Pastaj, të shkojmë edhe te objektet private.

Faleminderit!

Dorina Çinari - Faleminderit!

Unë do t'ia kaloj fjalën drejtorit Ligjor të ministrisë për të shpjeguar se cila procedurë është thjeshtuar.

Për sa i përket investigimit të godinave të institucioneve publike, nëpërmjet Agjencisë për Eficiencën e Energjisë, Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës ka nisur një projekt të madh të inspektimit të gjendjes fizike të godinave. Së pari, po bëjmë inventarin e këtyre godinave dhe më pas do të shohim se cila është gjendja fizike dhe cilat do të jenë nevojat e tyre për rikonstrukcion sipas parimeve të eficiencës së energjisë. Shumë shpejt do t'i kemi edhe rezultatet e këtyre inspektimeve. Kemi edhe angazhimin e BB-së. Me kërkesën tuaj, do të vijmë për të paraqitur rezultatet e këtij inspektimi.

Për sa i përket thjeshtimit të procedurave, do t'ia kaloj fjalën drejtorit Ligjor.

Rakip Suli – Konkretisht, ne kemi shembullin më të mirë sot për 4 godinat që po bëhen te Fakulteti i Inxhinierisë. Ato po ndërtohen me standardet e BE-së. Ky është shembulli më i mirë, sepse mesa mbaj mend, ka qenë një projekt me fondet e KfW-së. Aty po bëhet një punë konkrete dhe ai është modeli që ne duhet ta marrim për të gjitha objektet, qoftë ato shtetërore, qoftë ato private nesër.

Faleminderit!

Dorina Çinari - Kjo është e saktë. Janë 4 godina që po bëhen te Qyteti Studenti nr. 2; Janë edhe 6 godina te Qyteti Studenti nr. 1, të cilat po rristrukturohen plotësisht sipas parimeve të eficiencës së energjisë.

Niko Peleshi – Ka përgjigje tjetër?

Enea Karakaci – Kisha një sqarim të shkurtër për sa i përket thjeshtimit të procedurave. Siç është përcaktuar në ligjin aktual për eficiencën e energjisë, auditimet e energjisë dhe shërbimet energjetike kryhen nga subjekte të licencuara gjë që nënkupton që përveç pajisjes së këtyre subjekteve me një certifikatë nga drejtuesi teknik i tyre, siç është aktualisht procedura që ne po thjeshtojmë, përveç kësaj, ata duhet të shkojnë edhe në QKB dhe të kryejnë procedurat dokumentare, që përcaktohen aty.

Në kuadër të reformës së derregullimit, siç e tha edhe zëvendësministria, është ngritur në Kryeministri një grup ndërmintor, i cili i ka marrë në sitë të gjitha ligjet që janë në fuqi, që parashikojnë elemente licencimi. Në këtë komision ka kaluar para disa muajsh ligji i gazit natyror, që kishte të njëjtën natyrë: heqjen e licencës, thjeshtimin e procedurës dhe kryerjen e këtyre procedurave vetëm nga drejtuesit teknikë, të certifikuar, pa pasur nevojën e shkuar në QKB për t'u regjistruar dhe për të marrë një licencë.

Niko Peleshi – Pra, përgjigja juaj është që sot ka edhe certifikim, edhe licencim nga QKB-ja. Tani, me këtë ligj, po e heqim licencimin nga QKB-ja dhe do të mbetet vetëm certifikimi?

Enea Karakaci – Po.

Niko Peleshi – Kam përshtypjen se relatori ngriti shqetësimin e mospërcaktimit diku në projektligj, pra ka një vakuum se kush e certifikon audituesin energjetik.

Enea Karakaci – Kisha një sqarim të shkurtër për sa i përket vakuimit. Ky vakuum është krijuar për shkak të redaktimit të aktit. Në nenin përkatës është marrë tipologjia identike e fjalëve të licencimit, por të gjitha licencat aktualisht përcaktohen me një VKM të posaçme nr. 538. Në këtë VKM, e cila përcakton të gjitha licencat, që jepen në Republikën e Shqipërisë, përveç tipologjisë së licencës përcaktohen edhe disa kushte të tjera, si kategoria (nëse është e kategorisë së parë, të dytë apo të tretë) dhe po ashtu, dokumentacioni përkatës për secilën kategori.

Duke hequr fjalën “licencë” nga neni përkatës dhe duke lënë vetëm fjalën “certifikatë”, sigurisht ka dalë e zbuluar pjesa e procedurës. Ne duhet ta themi me VKM, se ku parashikohet edhe procedura përkatëse e dhënies së certifikatës.

Niko Peleshi – Dakord.

Vazhdojmë me pyetjet e tjera. Do t’i mbledhim të gjitha pyetjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka edhe një përgjigje. Ju lutem, pa përsëritje për ta shteruar si çështje.

Dorina Çinari - Kam një sqarim, sepse shoh që është i nevojshëm. Deri sot nuk është iniciuar si proces, sepse pas daljes së ligjit u përgatitën aktet e tjera të nevojshme dhe u krijua Agjencia për Eficiencën e Energjisë. Ne kemi përgatitur draftin e aktit për licencimin bazuar në ligjin që është aktualisht në fuqi, para ndryshimit që po përgatitet para jush. Të gjitha kategoritë, kriteret, procedurat, si do të licencohen këta auditues, janë të përcaktuar tashmë në draftin që ne e kemi hartuar.

Për sqarim, janë futur inxhinierë të të gjitha profesioneve. Kërkohej një eksperiencë minimale për t’i hapur rrugë tregut të këtij profesioni. Kërkohej një kurs trajnimi pasuniversitar i kryer për këtë fushë, duke qenë se është një degë e re dhe një fushë e re. Më pas, do të bëhet testimi pranë Agjencisë për Eficiencën e Energjisë. Të gjitha këto procedura janë parashikuar tashmë te drafti, të cilin ne e stopuam për momentin derisa të kalojë ndryshimi i ligjit, që do ta lehtësojë procedurën. Pra, do të jetë një procedurë më e thjeshtë pa kaluar në QKB, por vetëm certifikimi pranë ministrisë dhe Agjencisë për Eficiencën e Energjisë vetëm me një komision të përbashkët.

Niko Peleshi – Dakord.

Vazhdojmë me pyetjet e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka zoti Beqaj dhe me radhë. I mbledhim të gjitha pyetjet dhe më pas, do të vijojmë me diskutimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të flasë Iliri një herë, se mbase sqarohemi nga shpjegimi i Ilirit.

Ilir Beqaj – Besoj se pyetja e parë u shterua, sepse pyetja ime ishte se sa auditues kanë licencë deri më sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, zero.

Atëherë, cila është shkalla e zbatimit të ligjit të vitit 2015 e deri sot? A jemi vonë me afatet, që i kishim vënë vetes në vitin 2015 dhe sa vonë jemi?

E dyta, reforma e derregullimit u bë tashmë 1 vit që ka nisur. Sigurisht, ju si ministri, mbulonit më shumë se gjysmën e aktiviteteve ekonomike dhe profesionale të vendit. Ju keni ardhur herë pas here në komision për ndryshime ligjesh për rastet e tjera. A keni më ligje për të sjellë ju, si ministri? Flas për të gjitha fushat (360 gradë, det, ajër, tokë dhe nëntokë). A keni më, apo jo për ta mbyllur ligjërisht derregullimin?

E treta, u bënë 10-12 ditë, që ka filluar zbatimi i taksës së re të plastikës me 35 lekë për kilogram për importet, e cila ka filluar të efektojë direkt në profilet PVC për dritare, për eficiencën e energjisë.

Në qoftë se sot e mbështesim eficiencën e energjisë me ligje, me kredi të buta, me fonde, me Kodin e Ndërtimit, ka 10 ditë që importuesit e profileve të PVC-së për eficiencën e energjisë, po paguajnë në doganë 30% më shumë. Mendoni se kjo do ta frenojë realisht zbatimin ose do t'i frenojë përfitimet që mund të vijnë nga zbatimi i këtij ligji?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Pyetja e parë, ka lidhje me pyetjen e zotit Beqaj, e cila lidhet me zbatimin e ligjit. Në fakt, unë e kisha pyetjen më konkrete. A kanë dalë të gjitha aktet nënligjore të parashikuara në ligj? Meqë kam qenë pjesë e grupit të hartimit të ligjit, e kam kujdes të veçantë pjesën zbatimit të tij.

Te pjesa e auditit, meqenëse ju sapo e përmendët faktin që profesionistët duhet të bëjnë një kurs pasuniversitar, që më pas të mund të angazhohen në këtë profesion, nuk e di nëse keni parashikuar apo keni ndonjë marrëveshje me ndonjë universitet?

Para disa vjetësh ne kemi bërë një marrëveshje me Universitetin Bujqësor për trajnimin e vlerësuesve të pasurive të paluajtshme. Ne bëmë një kurs dhe padyshim, ata që do të licencoheshin duhej ta kishin kryer këtë kurs në Universitetin Bujqësor. Meqenëse po flasim për

bashkëpunimin me universitetet, mendoj se do të ishte e udhës të kishte një bashkëpunim konkret me universitetin në mënyrë që ata që do të licencoheshin të diplomoheshin dhe të bënin një kurs pasuniversitar në Universitetin e Tiranës, në Universitetin Politeknik, apo në varësi të specifikave, me një universitet tjetër për të siguruar edhe një bashkëpunim mes ministrisë suaj.

Pyetja tjetër: Cili do të jetë impakti? Si do të ndikojë ndryshimi i këtij ligji në treg dhe në sigurinë që do të ofrohet për energjinë, duke qenë se do të kemi auditues të tillë më profesionistë dhe më ekspertë?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Bitri!

Robert Bitri – Kur mendoni ju se do të jetë gati të fillojë i tërë procesi?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Baraj!

Besnik Baraj – Unë kam disa komente për ndonjë nen, por tani po mjaftohem të pyetja, duke sjellë këtu një shqetësim. Pajisja në përgjithësi me licenca ka rezultuar problematike në sektorë të ndryshëm në vendin tonë. Më skandalozja është të vlerësimet e ndikimit në mjedis. Unë kam shqetësim se mos degradon edhe kjo nismë dhe arrin në një situatë të ngjashme.

Unë do të pyesja për këtë: Pse nuk është specifikuar këtu arsimimi i atyre që do të marrin këtë lloj licence, të paktën në këtë ligj, sepse te VNM-të thuhet profesor fizikulture, artistë, që japin një provim dhe ...?

Së dyti, mendoj se për katedrat përkatëse, që janë të lidhura drejtpërdrejt me këtë, duhet të pasqyrohet në ligj që profesorët licencohen automatikisht. Pra, ligji të parashikojë që të certifikohen pa qenë nevoja të japin provime siç ndodh te VNM-të. Pra, profesorët që do të kualifikojnë ata studentë apo inxhinierë të jenë të certifikuar dhe të kenë të drejtën e tyre për të luajtur këtë rol për auditimin nëse kanë predispozicion për t'u angazhuar. Kjo është një ndihmë në kuadrin e gjithë asaj problematike komplekse që është shfaqur kohët e fundit.

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera? Jo.

Ju lutem, përgjigjuni!

Entela Çipa – Faleminderit për pyetjet!

Për sa i përket pyetjes për shkallën e zbatimit të këtij ligji, mund t'ju them se me krijimin e Agjencisë së Eficiencës është hartuar plani kombëtar i eficiencës së energjisë, që është dokumenti bazë që përcakton të gjitha masat. Në dhjetor të vitit 2017 është miratuar plani kombëtar 2018-2020, i cili përcakton objektivin kombëtar të Shqipërisë në kuadër të detyrimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për reduktimin në 6,8% të konsumit që ne aktualisht kemi deri në vitin 2020. Në kuadër të masave që do të merren për eficiencën janë përcaktuar hapat konkrete ligjore dhe rregullatore në këtë fushë si dhe impakti që ato kanë.

Ne jemi duke implemtuar, siç e tha edhe zëvendësministria, një projekt, i bërë edhe me fondet e buxhetit. Duhet të kemi parasysh që efienca e energjisë ishte hallka e fundit pas reformës në sektorin e energjisë, sepse pa pasur një sektor të strukturuar dhe pa ulur humbjet ne nuk mund të flisnim për eficiencë të energjisë. Pra, pas strukturimit të çmimeve të kompanive, në kuadër të angazhimeve globale për reduktimin e CO₂, që Shqipëria ka, tani janë masat konkrete që duhet të implementohen për reduktimin e konsumit.

Për sa i takon pyetjes nëse kemi marrëveshje me ndonjë universitet, kjo është një fushë e lirë. Ne nuk mund të imponojmë marrëveshje. Deri më sot, me sa kam dijeni dhe sa jemi informuar, aktualisht zbatohen disa programe.

Dua t'ju bëj me dije që drafti është hartuar, është diskutuar gjatë me të gjithë ekspertët e fushës, por u pezullua për faktin se ishte iniciuar ky ndryshim. Ne kemi marrë edhe mendimet e ministrive përgjegjëse. Pra, duke iu përgjigjur pyetjes së zotit Bitri, mendojmë se menjëherë pas miratimit të këtij ndryshimi janë të gjitha aktet, procedurat, licencimet, certifikatat, modelet, të cilat shumë shpejt do t'i realizojmë. Pra, do të miratohet vendimi i Këshillit të Ministrave për kushtet dhe kategoritë.

Për sa i takon pyetjes së zotit Baraj se cilat janë profesionet në draftin që ne kemi hartuar me vendim të Këshillit të Ministrave, janë vetëm inxhinierë. Madje kemi kërkesa nga shumë grupe interesi për ekonomistë, juristë, por e kemi vendosur për vetëm inxhinierë me profil mekanik, elektrik, fizik, elektronik, urbanistik, ndërtim. Vetëm inxhinierë, sepse është një profesion i vështirë që kërkon specifikim dhe përvojë në këtë fushë. Një nga kriteret është që të kenë kryer edhe kurse pasuniversitare. Në momentin kur kemi hartuar draftin e Këshillit të Ministrave kemi zhvilluar një diskutim me profesorët për mënyrën si do të bëhet certifikimi i tyre, nëse mund të merret automatikisht, ndërkohë që procedurat nuk e lejojmë këtë gjë. Mund të

procedojmë me disa lehtësime për ata profesorë që aktualisht kemi, por kemi pasur një ndikim nga inxhinierët e rinj, të cilët thonë që ne jemi më të kualifikuar, kanë studiuar jashtë apo kanë kryer kurset e audituesve të eficiencës së energjisë. Pra, është një proces që ne po e rregullojmë duke vendosur disa kritere për ata që kanë grada profesorë, të cilët mund të përjashtohen nga testimi dhe ta marrin direkt certifikatën për të krijuar atë bazë të gjerë të fillimit, të cilët do të certifikojnë audituesit e rinj të eficiencës.

Në këtë kuadër, Agjencia është duke u përpjekur për të gjetur një bashkëpunim. I kemi kërkuar KfW-së, edhe autoriteteve homologe italiane, që në komisionin e certifikimit të vijë edhe specialistë të fushës që të jenë pjesë e komisionit që do të ngrejë ministria.

Besnik Baraj – Kam një koment të vogël për këtë.

Jam dakord që të ketë një gradë të caktuar shkencore për të mos e masivizuar, por duhet pak iniciativë nga ana juaj. Nuk ka arsye që ju si institucion të thyheni nga presioni i të diplomuarve rishtas, qoftë jashtë, qoftë brenda vendit, në një kohë që ky staf akademik trajnon ose bën kurse.

Duke e kufizuar te profesor i asociuar, unë mendoj se nuk është numerikisht i madh, por është një lloj stimuli dhe reflektim i kësaj situate që universiteti praktikisht është duke kaluar që nuk ka lidhje fare me ekonominë e vendit. Këtu nuk është vetëm faji i universitetit, por edhe i politikës, që nuk ka siguruar urat e komunikimit për të nxitur këtë pjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ata u nënshtrohen rregullave të vendosura nga rregulloret përkatëse, kurse ata që kanë tituj shkencorë dhe që praktikisht bëjnë kurset duhet ta marrin automatikisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ata kanë si kusht që të bëjnë 1 vit apo 6 muaj kurs.

Entela Çipa – Për sa u takon kurseve, që aktualisht bëhen nga sistemi, ata kanë filluar. Është një aktivitet që nuk rregullohet nga ministria jonë por nga Ministria e Arsimit. Atje paraqesin kurrikulat dhe kanë në bazë të ligjit për arsimin mënyrën se si licencohen për atë aktivitet që kryen.

Besnik Baraj – Unë mendoj se çështja e profesorëve dhe profesorëve të asociuar duhet të jetë e sqaruar në mënyrë eksplicite në rregulloret përkatëse ose të futet në ligj.

Entela Çipa – Do ta marrim në konsideratë në momentin që do të miratohet vendimi i Këshillit të Ministrave. Kemi pasur një diskutim me ta se si mund të akomodohen më lehtë pa u futur në procedurën e testimit, sepse duke pasur një shkallë të caktuar ...

Besnik Baraj – Këtu ka të bëjë shumë edhe fokusi si e prezantoni ju në Këshillin e Ministrave. Duhet të ketë predispozicion nga ju në radhë të parë duke nxjerrë në pah pozitivitetet. Nëse e paraqisni në këtë formë mund të them që kalon.

Niko Peleshi – Dakord. Ka komente apo diskutime?

Po, zoti Panariti.

Edmond Panariti – Për të thënë të drejtën, çështjen e auditimit, personalisht, e kam të paqartë. Unë kam bindjen se çështja e eficiencës së energjisë në tërësi është zëvendësim teknologjie. Në rast se ti heq dorë nga një teknologji ekzistuese dhe fut në lojë një teknologji të re, e cila është më efiçente, për shembull për ngrohjen me kaldaja heq naftën dhe fut bërsinë e ullirit apo në pallatet e Tiranës, që 70% e tyre janë pa kapota veshëse, me incentiva ti vendos kapotën veshëse, këtu në thelb kemi zëvendësim të një teknologjie. Implementon diçka që e ka të certifikuar në vetvete reduktimin e humbjeve energjetike. Kështu që, mendoj se nuk ka nevojë për ndonjë shkencë të madhe, mjafton që mbi bazën e një protokollit të shikohet si janë realizuar punimet dhe si është zbatuar teknologjia që parashkruhet në letër.

Pavarësisht respektit të madh që kam për profesor Besnikun, mendoj se nuk është e nevojshme të fusim kriterin e profesorit apo profesorit të asociuar, sepse kjo nuk është akademizëm. Ne nuk do të shpikim teknologji që të kërkohet input i madh akademik, është thjesht një teknologji që ne e bartim, e implementojmë dhe duhet ta supervizojmë në pikëpamje të implementimit dhe natyrisht ta incentivojmë nëse kemi mundësi, sepse kuptohet që ka një kosto shtesë. Këtu hyn edhe roli i qeverisë. Në çdo investim që bëhet për këto teknologji që reduktojnë humbjet e energjisë ne kontribuojmë me 20, 30 apo 50 ... Më duket se bashkia e Tiranës i incentivon ...

Në këtë kuptim, është thjesht një protokoll që duhet kontrolluar dhe mendoj se mund të hapet. Nuk kemi pse e kufizojmë vetëm tek inxhinierët. Këtu kërkohet një person metikuloz, i cili ka njohuri të thelluara dhe provon me kualifikime pasuniversitare që zotëron formimin bazë, pra, ka konceptin çdo do të thotë eficiencë energjetike, reduktim i humbjeve, zëvendësim i teknologjisë dhe natyrisht mund të jetë pjesë e këtij procesi. Pra, edhe mund të thjeshtohet. Mirë

do të ishte të përfshihej bota akademike. Vërtet ne duhet ta hapim tregun apo mund të kontraktohen qendra të specializuara që të bëhen pjesë e këtij procesi.

Pra, ta thjeshtojmë dhe të mos e ndërlikojmë, sepse bëhet fjalë për zëvendësim teknologjie. Teknologjitë ekzistuese zëvendësohen me teknologji të reja që e bartin në vetvete dhe janë ato të certifikuara. Ato janë të certifikuara nëse zbatohen motamo sipas asaj që parashkruhet në kartën e tyre teknologjike, që e kanë vetë të inkorporuar eficiencën energjetike.

Nëse ne vendosim kapotat mbështjellëse në pallatet e Tiranës, kuptohet që ajo e ka të shkruar certifikatën e reduktimit të energjisë. Nuk ka nevojë ta testojë profesor doktor filani. Vetëm të zbatohet një për një dhe të kërkohet nëse punimet janë realizuar sipas kartës teknologjike dhe çfarë parashkruhet. Pra, të mos ndërlikojmë shumë, sepse po futëm faktorin njerëzor, do të thotë prit sa ta shikoj, studioj e të tjera.

Unë vij nga bota akademike. Mendoj se duhet ta thjeshtojmë procesin. Ka një kartë teknologjike që duhet të zbatohet nga a-ja te zh-ja, siç parashkruhet në teknologjinë e shkruar.

Ka ardhur momenti që përveç objektivave të vendosur që Shqipëria të rrisë me kaq eficiencën e energjisë, detyrimi që kemi të akti për ngrohjen globale, ulje e emetimeve CO₂, unë mendoj që auditimi duhet të jetë sa më shumë me reduktim të subjektivitetit njerëzor. Pra, mundësisht të jetë vetëm *check list* ... Nëse nuk është bërë, nuk ja vlen, nëse është bërë, dakord.

Nëse e fusim në interpretime akademike, kjo histori do të ndërlikohet dhe do të zgjasë.

Niko Peleshi – Një përgjigje nga zëvendësministrja dhe pastaj fjalën e ka zoti Beqaj. Më pas zonja Gjermani.

Dorina Çinari – Audituesi i energjisë nuk është detyrë akademike, por një detyrë projektimi. Pra, na duhet inxhinierë, sepse do të projektojnë, vlerësojnë, matin, llogarisin dhe propozojnë. Në fund do të ndjekin ekzekutimin e masave që ka propozuar audituesi i energjisë. Aty nuk mund të kemi as profesorë fizikulture dhe as ekonomistë. Është detyrë projektimi. Edhe kapotën, që mendoni ju, duhet ta projektojë dikush dhe duhet ta vendosë në harmoni me elementet e tjera të projektit. Nuk është detyrë akademike, por terreni, si të gjitha detyrat projektuese të arkitektëve dhe inxhinierëve në përgjithësi. Ne nuk po shpikim një profesion të ri. Është një nga kërkesat e akteve, që na vijnë nga komuniteti i energjisë, nga paketa e tretë e energjisë... Është një profesion i ri, por në bazën e tij ka inxhinierinë.

Edmond Panariti – Kapota nuk ka nevojë të projektohet nga inxhinierë shqiptarë. Thjesht...

Dorina Cinari – Asgjë nuk do të shpikim.

Edmond Panariti – Thjesht do të implementohet sipas disa kriterëve, që janë të parashkruara në kartën teknologjike.

Çfarë duhet të certifikojë tani kapota? Kapota është e certifikuar nga ai që e ka prodhuar.

Dorina Cinari – Do ta projektojë.

Edmond Panariti – I kanë firmat inxhinierët e ndërtimit. Vetëm kërkohej të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Një minutë.

E ka kërkuar fjalën zoti Beqaj, zonja Gjermani, zoti Bici dhe më pas zoti Pëllumbi dhe zoti Baraj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Arben Pëllumbi – Duhet të kemi parasysh se procedura që vjen mbrapa, është ajo e standardizimit. Kjo do të thotë se ne duhet t'i përcaktojmë në një manual të caktuar klasat energjetike. Përcaktimi i klasave energjetike ka të bëjë me fazën për të cilën folëm, me fazën e projektimit. Pra, këtë godinë ne mund ta bëjmë me klasë energjetike A+++ ose mund ta bëjmë me klasë energjetike B. Zbatimin dhe kontrollin e asaj që është zbatuar e bëjnë pikërisht audituesit për të cilët po flasim. Detyrëmisht, në varësi të projektit që do të bëhet për klasën energjetike të përcaktuar, bëhet edhe kontrolli përkatës, për të nxjerrë më pas nëse është zbatuar ose jo kjo teknologji që është thënë. Pra, nuk ka të bëjë thjeshtë me një kapotë, me një dritare e të tjerë. Kjo është vetëm për objektet civile.

Nga ana tjetër, kemi edhe objektet industriale. Kemi edhe linjat e prodhimit, të cilat, gjithashtu, futen në procesin e eficiencës energjetike, ku ka nevojë për specialistë më të lartë të fushës, për njerëz me kualifikim edhe më të lartë, sepse do të ndërhyjnë në proceset teknologjike. Nuk është thjesht “po kursejmë pak energji”, por është një koncept i tërë modern i prodhimit të energjisë duke e kursyer atë.

Këtu profesorët hyjnë në fazën e parë, ku na certifikojnë disa njerëz, të cilët pastaj do të punojnë në terren. Janë njerëz që do të merren pothuajse me shumicën e objekteve, qofshin këto civile, qofshin industriale. Që të mund ta bëjnë këtë gjë, ata duhet të kenë një standard, një klasë energjetike të caktuar, sepse klasa energjetike i shton vlerën objektit.

Ne qoftë se nesër nxjerrim një apartament në shitje dhe ka vlerën x , sepse është i klasës energjetike D, po u bë i klasës energjetike A+, ka një vlerë shtesë.

E gjithë kjo presupozon një proces të mirëfilltë, që ne po e nisim sot. Përfundon me bërjen e këtij standardi dhe më pas hyn në lojë gjithë kjo armatë njerëzish profesionistë të fushave të ndryshme, inxhinierët e ndërtimit, inxhinierët arkitektë, inxhinierët mekanikë, inxhinierët elektrikë... Të gjithë bashkë, bëjnë një grup njerëzish, që arrin të certifikojë një objekt apo një industri të caktuar. Nuk është një person që mund ta bëjë këtë gjë. Sigurisht, në një objekt ndikon edhe dritarja, por është një inxhinier arkitekt ai që thotë nëse është e montuar në mënyrën e duhur dhe a e siguron këtë klasë energjetike sipas standardit të përcaktuar, pra a ia japim dot kësaj godine një A++, në qoftë se kjo dritare është e montuar siç duhet apo jo. Për këtë duhet një profesionist i fushës së caktuar.

Në qoftë se flasim për skemat ngrohjes, duhet një inxhinier termik. Në qoftë se flasim për një eficiencë energjetike në konsumin e energjisë elektrike, duhet një inxhinier elektrik. Të gjithë këta profesionistë duhet të kenë bërë edhe një kurs shtesë, për të kuptuar se kur kursehet, si kursehet dhe cilat janë teknologjitë e reja sot për të kursyer sipas standardeve, të cilat nuk janë thjesht tonat, por janë standarde europiane, që edhe ne duhet t'i implementojmë. Besoj se është në fazën pasardhëse.

Niko Peleshi – Dakord.

Faleminderit!

Ka komente të tjera?

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Besoj se edhe në këtë proces ne nuk mund të dalim nga hallkat normale që ka çdo proces tjetër teknologjik në Shqipëri.

Ka një projektues, që ka një leje të caktuar, ka një ndjekës teknik zbatimi burimesh, që ka një licencë të caktuar, ka një supervisor apo një drejtues punimesh, ka edhe një kolaudues në

fund. Këto katër hallka janë në hidraulikë, në termo, në mekanikë, në ndërtim, kudo. Duhet të jenë edhe këtu.

Ndërkohë, mendoj se duhet të kemi parasysh edhe diçka tjetër. Ky është një nga aspektet e përdorimit eficient të burimit të energjisë dhe të shfrytëzimit të energjisë. Ka edhe një moment të dytë, që lidhet me gjithë këtë reformë të madhe që kemi ndërmarrë.

Në qoftë se duam të fusim në lojë burimet alternative, të gjithë ata që duan të investojnë, thonë: “Duam të punojmë në dy drejtime”. Pra, unë kam në tarracën time një panel diellor, por, kur e kam tepër dhe dua ta rihedh në treg.

Për këtë shkëmbim bilanci duhet një profesionist i caktuar, që punon në një kuadër të rregulluar. E quajmë auditues, inspektor apo kolaudues, emri pastaj ngelet kapistallë. Nevoja e kësaj lloji detyre, që mbrapa ka një profil të caktuar profesional, mendoj se është e pashmangshme.

Niko Peleshi – Zonja Gjermani e ka kërkuar fjalën.

Eglantina Gjermani – Faleminderit!

Doja të rithekosja atë që tha zëvendësministrja, edhe për faktin se (nga përvoja) ne mund të bëjmë ndërtime, por vuajmë shumë nga inspektimi, kontrolli apo certifikimi i sigurisë së tyre.

Në momentin kur flasim për eficiencën e energjisë, që relativisht është një përjasje e re në Shqipëri, hapet një treg pune për profesionistët inxhinierë, të cilët, përmes një kursi apo ekspertize të veçantë, do ta ofrojnë këtë (mendoj se universitetet shqiptare mund ta bëjnë shumë mirë këtë), që të sigurojnë ekspertizën e nevojshme në treg. Besoj se këto janë parime të njëjta edhe me audituesit financiarë. Sigurisht, ne themi se e bëjnë ekonomistët, se pse duhet auditimi, por i përdorim. Pra, është i njëjti parim.

Jo pa qëllim e theksova bashkëpunimin me universitetet, duke dashur që vërtet të bashkëpunohet me Ministrinë e Arsimit dhe kurrikulat që përdorin universitetet për audituesit energjetikë, që t’ju vlejné më shumë juve, t’i vlejné tregut të punës dhe të na japin një garanci më shumë, që, për eficiencën e energjisë i kemi këta profesionistë kaq të mirë dhe, më pas, mundësisht me vendimin e Këshillit të Ministrave që ju keni hartuar dhe me mendimet e ministrive të tjera që keni marrë... Kam merakun se si do të monitorohen më pas parametrat apo kriteret e cilësisë së punës së tyre (marrin certifikatën, po bëjnë këtë audit...), qoftë kriteret apo

standardet me të cilat do ta vlerësojnë punën, qoftë edhe penalitetet, në qoftë se kanë përgjegjësi dhe nuk e kanë bërë mirë punën.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Bici dhe zoti Suli.

Dritan Bici – Së pari, nuk e shikoj si një element të ri të futur... Qëllimi i ligjit është që nga licencim të bëhet certifikim. Ne po flasim këtu sikur ky auditues energjetik është një element i ri i futur. Këtu thjesht projektligji dhe Ministria e Energjetikes synon të shkëpusë një hallkë të tepërt dhe ta thjeshtëzojë, në kuptimin e zbatimit të eficiencës së energjisë, e cila presupozon prodhim energjie me eficiencë dhe shfrytëzimin e energjisë me eficiencë. Është një gamë shumë e gjerë efienca e energjisë. Në vendin tonë jemi pothuajse në hapat e parë të vendosjes së këtij elementi.

Sot e kësaj dite ne vazhdojmë të ndërtojmë konvikte... Pavarësisht se këto që po bëhen tani janë me standarde, ndoshta nëpër rrethe ndërtohen me avazin e parë. Ky është një element shumë i rëndësishëm. Duhet të kërkohen auditues energjetikë, që të mos lejojmë të vazhdohet me historitë e shkuara.

Elementi i këtyre inxhinierëve të rinj më duket i goditur, sepse ne e shikojmë edhe në jetën e përditshme, që, elektrikistët dhe inxhinierët që kanë punuar vetëm në Shqipëri janë zero, kurse ata që kanë punuar dhe janë shkolluar në Itali, në Greqi, më mirë akoma, në Amerikë apo në Angli, janë shumë herë më lart. Instalimet elektrike në shtëpi i ke të mbaruara po i bëre me këta të vendit. Është një element shumë i gjetur, që të shfrytëzohen persona që kanë studiuar dhe punuar jashtë, sepse ata janë para nesh, Bashkimi European po e po, por edhe vendet e tjera.

I falënderoj përfaqësuesit e ministrisë për shpjegimet që dhanë! Ishin shpjegime me kompetencë... Njëkohësisht, shpresoj që ministria të bëjë rol kontrollues shumë të rreptë për eficiencën e energjisë këtej e tutje.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Zoti Suli, kenë gjë për të shtuar?

Rakip Suli – Mbase e kam gabim, por mendoj se sot duhet të ndajmë dy gjëra: burimet alternative për konsumimin apo eficiencën e energjisë dhe licencimin e auditimit. T'i ndajmë gjërat. Është tjetër gjë licencimi për të cilin flasim ne dhe tjetër gjë janë burimet alternative. Në

ç'kuptim? Unë mund të ngrohem në shtëpi, si të thuash, edhe me energji, edhe me panel diellor. Ne nuk po flasim sot për burimet alternative që... Ne po flasim për licencimin. Unë mendoj, mbase edhe gabohem, që nuk kemi pse të vëmë shumë kufi te pjesa e licencimeve, sepse (nuk e di se kush e tha nga kolegët) kjo nuk është ndonjë filozofi e madhe.

Së pari, do të jenë të përcaktuara në projekt punimet që do të bëhen për këtë objekt.

Së dyti, edhe për objektet që janë në rikonstrukcion, janë të përcaktuara punime, të cilat i përkasin përsëri eficiencës së energjisë.

Të ndajmë burimet alternative, po flas për eficiencën, nga licencimi i kontrollit të punimeve që do të behën nesër. Nuk kemi pse të vëmë shumë kufizime në këtë drejtim.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Baraj, keni fjalën.

Besnik Baraj – Desha të prek dy momente, së pari, për komentin që bëri zoti Panarit dhe zoti Suli tani në fund.

Kur flas për pjesën akademike (nuk po them se aty bëhet shkencë, kjo është, si të thuash, *for granted*), ajo stimulohet pa kaluar në proceset ku mund të kalojë një i sapodiplomuar. Unë e quaj një stimul dhe e quaj të dobishme, që, një nivel i caktuar, në qoftë se do ta ushtrojë këtë aktivitet, le ta marrë atë.

Së dyti, hapja e profesioneve në kushtet kur kemi mijëra inxhinierë ndërtimi, mijëra inxhinierë mekanikë, arkitektë, inxhinierë elektrikë, hapja pa kufizim, duke e thjeshtëzuar procesin, që është vetëm një *tik* që mund të bëjmë për të vlerësuar, për mendimin tim, bie në kontradiktë edhe me shpjegimin e arsyeshëm që dha zoti Pëllumbi. Madje, nga shpjegimi i zotit Pëllumbi, duke pasur profile të ndryshme në këtë lloj certifikimi, ndoshta certifikimi duhet bërë nga ndonjë ekip dhe jo nga një njeri. Pra, duhet të ketë, në mënyrë paralele, sikurse për vlerësimin e diktimit në mjedis... Sot vlerësimin e ndikimit në mjedis e bën një kimist. Problematika e vlerësimit të ndikimit në mjedis kërkon biologun, agronomin, inxhinierin kimist, inxhinierin e ambientit e të tjerë. Kështu që është e gabuar ideja që ta bëjë një njeri.

Nisur nga ajo që tha Beni, ndoshta ju duhet ta rishikoni, për të thënë se duhet të ketë një subjekt që ka këto lloj profilesh dhe se certifikimi bëhet shumë më profesional, shumë më gjithëpërfshirës në problematikën e eficiencës së energjisë.

Lind pyetja: a mendoni se realisht mund ta bëjë certifikimin një person? Apo duhet një ekip?

Arben Pëllumbi – Thashë të sqaroj edhe diçka tjetër këtu.

Niko Peleshi – Të bëjë një sqarim zoti Pëllumbi dhe më pas zoti Marto.

Arben Pëllumbi – Ideja është kjo: pa kaluar faza tjetër e përcaktimit të klasave energjetike, ne hyjmë në këtë diskutim. Pse? Sepse në rast se bëhet fjalë për të certifikuar një apartament me një dhomë e një kuzhinë, i cili është i klasës energjetike D (se do të na lindë nesër kjo nevojë, pra unë dua të shes një shtëpi dhe do të vijmë nga agjencitë imobilare dhe të pyesin se çfarë klase energjetike e ke shtëpinë), unë do të marr një ekspert që të thotë se çfarë klase energjetike e kam këtë shtëpinë që dua të shes. Sigurisht, këtë duhet ta bëjë një individ i caktuar, që ka një licencë, sepse nuk do të bëjë ndërhyrje, por thjesht do të klasifikojë dhe do të vlerësojë. Në rast se bëhet fjalë për godina komplekse për industri komplekse, atëherë sigurisht që kjo nuk bëhet nga një individ. Nga ana tjetër, nëse bëhet fjalë për sipërfaqe të mëdha, prapë nuk bëhet nga një individ, por bëhet nga një grup individësh, prandaj edhe këtu në ligj është futur “persona juridikë”, por që kanë në përbërjen e tyre autidues të fushave përkatëse.

Besnik Baraj – Dua të bëj një replikë të vogël nisur nga eksperiencia shqiptare. Ka shumë raste që takojmë sharlatanë, kur vjen puna për të vlerësuar këtë 1 dhomë+kuzhinë që thatë ju...

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni një minutë!

Këta sharlatanë mund të hyjnë në bashkëpunim me agjencitë imobiliare dhe bëjnë vlerësimin A3+ kundrejt në shpërblimi, prandaj duhet tamam një subjekt juridik...

(Diskutime pa mikrofon)

Ne në Shqipëri kemi vuajtur më shumë nga kaosi sesa nga rregulli. Termi “le ta lëmë të lirë” e të tjera, për mua më shumë e ka dëmtuar zhvillimin e situatave të ndryshme në sektorë të ndryshëm sa u takon këtyre certifikimeve, prandaj do t’ju thosha se duhet bërë shumë kujdes.

Niko Peleshi – Zoti Marto, e ka fjalën.

Andrea Marto – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke qenë një fushë e re te ne, besoj se edhe ministria do ta ketë parasysh, duhet të përfitojmë nga eksperiencia e vendeve të suksesshme në këtë proces si në hartimin e standardeve

ndërtimore, edhe në fushën e auditimit, të kontrollit dhe të inspektimit. Pra, duhet të orientohejmë nga ato shtete që janë të suksesshme, sepse kanë këtë procedurë dhe duhet t'u përafrohemi atyre dhe jo të shpikim gjëra të reja.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

A ka komente të tjera? Nuk ka.

Atëherë po ju them edhe unë diçka pa u zgjatur. Siç e tha zoti Bici, këtu nuk është se jemi duke diskutuar për një profesion të ri apo për një fushë të re, në fakt, ne synojmë të deregulojmë shërbimet e auditimit dhe shërbimet e tjera energjetike. Duhet ta kemi të qartë se deregulim nuk do të thotë të liberalizojmë marrjen e certifikatës edhe për ata që nuk e meritojnë, duke ulur kërkesat, por kjo do të thotë se ata që meritojnë ta marrin më shpejt.

Nuk e di pse po zgjatemi kaq shumë!? Unë mendoj se po bazohemi te disa precedentë siç është vlerësimi i ndikimit në mjedis, që e tha edhe zoti Baraj, ku ai raporti formal shpeshherë është u kthyer në fiktiv. Pse është ky raport formal dhe fiktiv? Është formal edhe fiktiv, sepse nuk duan ose nuk dinë. Nuk duan vlerësuesit e ndikimit në mjedis në këtë rast, nuk dua t'i fus të gjithë në një thes, por kemi precedentë që na bëjnë të jemi të shqetësuar; nuk duan sepse nuk e kanë ndier forcën e zbatimit të ligjit, nuk i kanë ndier sanksionet në kurriz nga institucionet përgjegjëse. Ndaj, për të mitiguar këtë risk, pa dyshim, ashtu siç u tha edhe këtu në komision duhet që ministria ta mbajë shënim që të shtojë presionin dhe të krijojë precedentët e parë të sanksioneve ndaj auditiveve apo raportimeve fiktive.

Arsyeja tjetër është që nuk dinë. Pra, për ta mitiguar riskun e autidimeve të dobëta, sepse nuk dinë, dua t'ju theksoj edhe një herë atë që tha zonja Gjermani, ministria jo nuk ka se çfarë të bëjë, sepse është kompetencë e Ministrisë së Arsimit dhe e universiteteve, por ajo mund të ketë një rol proaktiv për të ndërtuar programe të përbashkëta të kualifikimit pasuniversitar specifike për një fushë të re dhe kaq interesante, siç është efienca e energjisë.

Duam precedentë? Po, kemi precedentë pozitivë, bashkëpunimin e Ministrisë së Kulturës me Universitetin Politeknik të Tiranës, para 2-3 vjetësh, për masterin e restaurimit. Zonja Gjermani e di mjaft mirë këtë gjë, sepse e ka drejtuar atë fushë. Restaurimi nuk është një fushë e re, në fakt, është një lloj specialiteti që nuk ka qenë i trajtuar në mënyrë speciale deri para këtij masteri profesional nga programet tona universitare apo pasuniversitare.

Pra, restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore e kryente kushdo që kishte një licencë arkitekti, por, në fakt, ka kaq shumë kërkesa specifike aq sa meritonte një kualifikim pasuniversitar. Është në të drejtën tuaj ta çmoni nëse duhet që audituesi apo projektuesi i objekteve energjetike eficiente, eficient nga pikëpamja energjetike, duhet të meritojë një kualifikim pasuniversitar master apo një formë tjetër kursi në mënyrë që të kemi në treg auditues, të cilët janë të formuar plotësisht dhe me standard të lartë për këtë fushë dhe nga ana tjetër, sapo të jenë të formuar dhe ta meritojnë certifikatën ta marrin atë sa më lehtë pa u endur nëpër zyra dhe pa iu nënshtruar burokracisë.

Siç u tha edhe nga relatori në fillim, procedura është pak e paqartë: kush e lëshon certifikatën dhe me çfarë lloj procedure? Pa dëgjuar konsensusin, do t'ju propozoja që sot ta miratojmë ligjin në parim. Sa i takon miratimit nën për nën duhet t'i japim pak kohë vetes deri në mbledhjen tjetër, për aq kohë sa relatori dhe përfaqësuesit e ministrisë të bëjnë rregullimet dhe plotësimet e nevojshme të ligjit, por, në qoftë se ju keni gjetur një zgjidhje më të shpejtë na e thoni.

Arben Pëllumbi – Siç e thashë edhe në fillim, ideja ishte që kalimi nga licencim në certifikim e largonte këtë proces nga një VKM e përcaktuar, ku tregoheshin edhe mënyrat se si licencohej. Kjo nuk ishte marrë parasysh në këtë pjesë, prandaj mendojmë që me ndërhyrjet që do të bëhen në nenin 3, pika 2, në të cilin thuhet: “Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për Energjinë” të shtohet edhe pjesa “si edhe procedurat për pajisjen me certifikatë”. Mendoj se në këtë mënyrë i japim zgjidhje procesit të pajisjes me certifikatë. Përcaktohet një procedurë me propozim të ministrit përgjegjës dhe nga Këshilli i Ministrave përcaktohet procedura se si të pajiset me certifikatë.

Niko Peleshi – Ju mendoni se me këtë plotësim nuk ka nevojë të presim, pra mund ta miratojmë sot projektligjin nën për nën?

Arben Pëllumbi – Po.

Niko Peleshi – A ke ndonjë koment tjetër?

Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Unë mendoj se kjo duhet ritheksuar kur të kalojmë në diskutimin nën për nën në seancën tjetër.

Niko Peleshi – Pra, ta lëmë për mbledhjen tjetër?

Besnik Baraj – Mund të reflektohet në draft...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zoti Pëllumbi, me këtë plotësim jemi të...

Arben Pëllumbi - Në lidhje me procedurën jemi, në lidhje me teknikën legislative, atë më pas duhet ta bisedojmë me juristët ose me Komisionin e Ligjeve.

Sa i takon teknikës, ne e zgjidhim procedurën...

Niko Peleshi – Në rregull, e lëmë për në mbledhjen tjetër.

Arben Pëllumbi - Teknika më pas ka nevojë për..

Niko Peleshi – Në rregull.

Propozimi është që sot ta miratojmë ligjin në parim dhe në mbledhjen tjetër ta miratojmë nen për nen, pasi të jenë bërë plotësimet dhe konsultat me ministrinë dhe me shërbimet e komisionit.

Kush është dakord për miratimin në parim të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 124/2015 “Për eficiencën e energjisë”? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në mbledhjen tjetër do të bëjmë diskutimin dhe miratimin nen për nen të projektligjit.

Falënderoj përfaqësuesit e ministrisë për prezantimin serioz dhe në nivel shumë të lartë!

MBYLLET MBLEDHJA